

**POSTMODERNA SUBLIME
(SHEMBULL PRAGMATIK: ROMANI POSTMODERN TË FSHEHTAT
E TREGUARA TË REXHEP QOSJES)**

**SUBLIME POSTMODERNISM
(PRAGMATIC EXAMPLE: REXHEP QOSJE'S POSTMODERN NOVEL
THE SECRETS REVEALED)**

Afrim REXHEPI

*Institute for Macedonian literature - Department of Albanian Literature in R. of North Macedonia, Ss. Cyril and Methodius University in
Skopje.*

** Corresponding author e – mail: aa_redzeqi@yahoo.com*

Abstract

Postmodern literary works, in the spirit of the aesthetics of the sublime, imply a disproportion between the artistic work and our (in)ability to display and interpret it; we have nothing to interpret, the postmodern text is a sublime act, it is an event, it simply happens. Such a textual event is also the postmodern parable of Rexhep Qosja, specifically the omnibus novel *The Secrets Revealed*, a novel distinguished by the poetics of paradox. The poetics of paradox marks the dissolution of meta-narratives. It operates through the play with discourses, the parodic, double-discourse of postmodern intertextuality, the play with fragments, with pieces of the whole, deep and ironic fractures that, according to Roland Barthes, “create the effect of a spark that draws attention.”

Keywords: roman, postmoderna, kategori estetike, sublimja, perceptioni etj.

Abstrakt

Vepra letrare postmoderne, në frymën e estetikës së sublimes, nënkupton disproporcion midis veprës artistike dhe (pa) mundësisë tonë që atë ta shfaqim dhe ta interpretojmë, nuk kemi ç’farë të interpretojmë, teksti postmodern është akt sublim, është ngjarje, thjesht ndodh. Një ndodhi e tillë tekstuale, është edhe parabola postmoderne e Rexhep Qosjes, konkretisht romani omnibus *Të fshehtat e treguara*, roman që dallohet me poetikën e antirregullit apo me poetikën e paradoksit. Poetika e antirregullit, shënon shkrirjen e metanarracioneve. Në funksion është loja me diskursat, diskursi i dyfishuar parodik i intertekstualitetit postmodern, loja me fragmentet, me copëzat e të plotës, çarje të thella e ironike që sipas R. Barthes “krijojnë efektin e një përshkëndije që tërheq vëmendje”.

Fjalë kyçe: roman, postmodernism, kategori estetike, the sublime, perception etj.

Hyrje

Përjetimi estetik - ndjesia e sublimes, është enigmë në vetvete dhe e tillë duhet të mbetet, pasi përzierja e frikës dhe e madhështisë (efekte emocionale këto që e përcaktojnë ndjesinë e sublimes), është enigmatike dhe e pakapshme për aftësitë tona gjykuuese. Përmes tekstit në analizë, do të përpiqemi të demonstrojmë faktin thelbësor që shkrimtari postmodern nuk mund ta kap të plotën, prandaj përmes një universi frazash - shprehje (sipas modelit teorik të L. Vitgenshtajnit: “Gjuha është sistem apo shumës i lojërave me fjalë” (Rexhepi 2010: 21), krijon veprën si konstrukcion ku e vërteta objektive nuk ekziston. Gjithnjë sipas teorisë estetike të J. F. Lyotard (në aspektin gjuhësor e ngritur mbi modelin teorik të Vitgenshtajnit), do të bëjmë

përpyqje për të demonstruar një botë objektive të lojërave të fjalëve e cila jo vetëm që përjetohet nga pikvështrimi i lexuesit, por është edhe akt sublim i autorit në krijimin e veprës.

Në tekst, do t'i besojmë thënies së estetit Zhak L. Nancy, përcaktimit epokal, “sublimja është në modë”, “në modë, çë dymijë vjet”. Pra, përvoja estetike e sublimes vazhdon të na provokojë përmes veprave letrare, vazhdon të na shokojë përmes përshkëndijave, shok – efekteve sublime, vazhdon të provokojë edhe vepra *Të fshehtat e treguara* e Rexhep Qosjes. Roman omnibus, me dokumente reale dhe imagjinare që nuk shpjegon botën, por rrëfen kotësinë, shëmtinë, të fshehtat e të panjohurat, roman që nuk e njeh të vërtetën objektive sepse atë e krijon përmes fjalëve që kuptimin e përfitojnë përmes korrespondimit midis tyre, jo në raport me të vërtetën objektive. Kjo është sublimja postmoderne e romanit omnibus *Të fshehtat e treguara*, pamundësia e autorit, përmes fjalëve korresponduese për ta kapur të plotën, pamundësia që estetikisht na shokon, na trondit. Përpyqja, tendenca, pamundësia e Qosjes përmes një romani postmodern të shpreh një rifillim të mundshëm, të shpreh të plotën, është akt sublim, është postmoderna sublime.

Sistemi i kategorive estetike – kategoria e sublimes

Sistemi i kategorive estetike i nxitur nga Uilijem Diltaj, e që funksionon sipas binomit subjekt (uni) – objekt (bota), me në qendër kategorinë e të bukurës (harmoninë e poseduar). Ky sistem vendos kategorinë e sublimes midis tragjikës dhe të bukurës, midis binomit subjekt (uni) dhe objekti (bota). Midis kategorive tragjika (në kërkim të harmonisë) dhe e bukura (harmonia e poseduar), vendoset kategoria e sublimes, ku objekti (bota) e dominon subjektin, por jo aq sa ta shkatërrojë atë sikur që ndodh me tragjiken. Në fakt, kategoria e sublimes posedon elemente të tragjikës, edhe të të bukurës, pra është një sintezë estetike e harmonisë së poseduar dhe e harmonisë së humbur. Ajo na ngjall lumturi në përpyqjen për ta shfaqur, por gjithashtu dhembje sepse nuk mund të shfaqet. Ky është definicioni i përgjithësuar i sublimes i përcaktuar përmes paradigmave teorikë të P. Longinit, E. Berk, I. Kant dhe Zhan F. Lyotard. Një thënie e teoricienit postmodern F. Lyotard thotë se kategoria e sublimes në epokën postmoderne, nuk ndodhet në vepër, por në spekulimet dhe teoritë paradoksale për postmodernen në art. Si shpjegohet kjo? Kjo ndodh me faktin që ndjenja e sublimes, që ngërthen frikën, tmerrin e madhëstsinë, është subjektive dhe e ndarë nga mendja, është enigmatike, është paradoksale, është konfuze dhe jo e kapshme nga mendja e morali.

Vepra artistike postmoderne, në frymën e estetikës së sublimes, nënkupton disproporcion midis veprës dhe (pa) mundësisë sonë për ta shfaqur dhe interpretuar atë. Nuk kemi ç'farë të interpretojmë, teksti postmodern është akt sublim, është ngjarje, që thjesht ndodh. Një ndodhi e tillë tekstuale, është edhe parabola postmoderne, e shtrirë në romanet që dallohen për poetikën e antirregullit apo të paradoksit. Poetika e antirregullit, shënon shkrirjen e metanarracioneve. Kjo funksionon përmes lojës me diskurset, duke e përfshirë diskursin e dyfishuar parodik të intertekstualitetit postmodern, lojën me fragmentet, copëzat e të plotës, çarjet e thella e ironike që sipas R. Bartit “krijojnë efektin e një përshkëndije që tërheq vëmendje”.

Postmodernizmi shqiptar

Postmodernizmi në letërsinë shqipe nuk vjen si një lëvizje uniforme letrare, por vjen në mënyrë fragmentare. Kështu studiuesja Floresha Dado e përcakton ardhjen e postmodernizmit në letërsinë shqipe. Në formën e tij të plotë, postmodernizmin e gjejmë në prozën e shkurtër të Ardian Kyçyikut, Arian Lekës etj., në poezi të Martin Camaj dhe Ervin Hatibi, ndërsa në roman e gjejmë në një mënyrë të paqartë dhe konfuz. Është konfuz për shkak se lexuesi i romaneve postmoderne ndjehet konfuz dhe i tronditur nga tekstet postmoderne që ofrojnë një poetikë e estetikë ndryshe nga tekstet realiste, socrealiste dhe moderniste. Në fakt, ky është edhe problemi

esencial i nivelit të ulët të receptimit të teksteve postmoderne nga lexuesi, sepse ai nuk është i informuar me kulturën e duhur për të shijuar estetikën pluraliste të romanit postmodern shqiptar. Megjithatë, postmoderna është estetike subjektive, siç e përcakton edhe Umberto Eko përmes momentit kur vështrojmë një pikturë në të cilën një njeri ndodhet para një hapësire pafundësisht të madhe e të madhërishtme. Ne nuk e shohim njeriun nga mbrapa, por shohim përmes tij atë që ai vetë e sheh. Pra, piktura shfaq sublimen dhe nxit përjetimin tonë për të. Nuk ekziston një horizonti pritjeje të formave moderne, por piktura është e hapur dhe ne jemi pjesë përbërëse e saj.

Në këtë kontekst, shpjegohet edhe teoria estetike e Kantit, gjithnjë sipas gjykimit teorik të Lyotard ku subjekti sublim është përjetësisht i ndarë nga objekti i dëshiruar. Të shfaqet ajo që nuk mund të shfaqet, të krijohet ajo që nuk mund të krijohet, është përpjekja sublime e romansierit postmodern i cili fuqishëm mendon për një rifillim të mundshëm. Në studimin antologjik *Gjendja postmoderne* e poststrukturalistit F. Lyotard, theksohet fakti që sublimja ndodh tani, por nuk mund të shfaqet, përveç faktit që duhet të pëpiqemi për ta shfaqur atë sepse e kemi nevojën tonë për sublimen por e kemi edhe shqetësimin tonë në raport me ndjesinë e apsolute. Një pragmë e njohur teorike është fakti që romanet moderne shkaktojnë përvoja sublime duke e orientuar lexuesin drejt kuptimeve të plota e transcendentale. Për shembull, pamjet e natyrës apo kodrat gjigante, janë të madhërishtme dhe shkaktojnë ndjenja të thella e të plota, ndërsa romanet postmoderne shkaktojnë ndjesinë e sublimes të fragmentuar, jo të plotë dhe krejt të pasigurtë në shprehjen e kaosit dhe të shumësisë së botës.

Ndjesia e përvoja e postmodernes sublime

Romani omnibus i R. Qosjes *Të fshehtat e treguara* është roman postmodern, është tekst në lëvizje, tekst polisemik, me estetikë plurale. Është proces komunikimi ndërmjet autorit, tekstit dhe lexuesit; është ngjarje, është efekt, është tekst që ndodh. Teksti që ndodh është i hapur për ndjesinë e përvojën e lexuesit. Në funksion, shënojmë një mundësi të interpretimit të postmodernizmit qosjan përmes postmodernes sublime e që nuk nënkupton objektin sublim siç ishte rasti me estetikën moderne, por subjektin sublim, përjetimin a ndjesinë subjektive të sublimes. Kjo shprehet përmes një modusi narrativ të R. Qosjes, ku ndjesia e sublimes shënon një dallim nga estetika e sublimes klasike, romantike dhe moderne. Është estetika postmoderne e sublimes, subjektive dhe dekonstruktive, e shprehur me lojërat gjuhësore, me paradokse të thella, të paqëndrueshme, kontradiktore dhe tërësisht tensive.

“Posa ulem në karrige, afër tryezës së punës, në të cilën i kam shkruar pothuaj të gjithë ata libra që kam shkruar deri sot, e, mjerisht, janë më shumë se ç’do të ishte mirë për mua, m’u bë se tryeza disi e mpakur nisi të largohet prej meje. Hej! Hej, ku do? E pyes, por ajo nuk më përgjigjet. Je në vete apo je çmendur në këtë vapë të madhe? E pyes prapë duke mos menduar se me këtë pyetje mund ta hidhëroj, por ajo as në këtë pyetje nuk më përgjigjet. Në vend që ta bezdis më tej me pyetje, duke pritur po- të e jo-të, u turra pas saj, natyrisht i ulur në karrige, derisa ajo, tryeza e punës, nuk u ndal te muri, në anën e djathtë të dritares. Këtu e kam vendin unë e jo atje në mes të dhomës, tha. Tani unë po të pyes ty se kush më ka qitur atje dhe më ka qitur atje, në mes të dhomës, pa më pyetur? Nuk dita t’i përgjigjem se kush e kishte hequr tryezën e punës prej vendit ku kishte qenë gjatë pesëdhjetë e pesë vjetëve dhe e kishte vënë në mes të dhomës, thuajse tani e tutje nuk do të shkruhej më në të, por do të luhej bixhoz!... Por, ndiej: sikleti nuk më ka kaluar. Uni im i parë pyet Unin tim të dytë: përse nuk të kaloi ai sikleti? Por, Uni i dytë, ndoshta pse është i dytë, nuk i përgjigjet Unit tim të parë. Dhe, nuk i përgjigjet ndoshta bash pse është Unë i dytë e Uni i dytë, si të gjithë unët e dytë, dëshirojnë t’i mistifikojnë përgjigjet që duhet t’u jepen pyetjeve të unëve të parë.”. (Qosja, 2020: 10)

Nga citati, vërehet rrëfimi dekonstruktiv e paradoksal, autoreferencial e i fragmentuar, lexohet dekonstrukcioni i subjektit, shumësia e unit që pyet veten dhe, përmes pyetjeve, shkakton

tension midis subjektit dhe objektit, midis reales dhe fiksionit. Dekonstruksioni i Unit: Uni i parë dhe Uni i dytë që nuk përgjigjet (sfidon konceptet tradicionale të identitetit), një identitet postmodern dhe i paqëndrueshëm, shkakton tension dhe përplasje midis tyre. Tensioni dhe përplasje, shkaktojnë ndjesinë sublime. Në citat, vërehet edhe simbolika e brendëshme e tipit postmodern, e shënuar përmes “sikletit” të autorit që nuk e kap e nuk e ndjenë kuptimin e plotë të botës, dhe e lexuesit që ndjenë përvojën sublime dhe intensitetin e tensionin e forcave kaotike. Ndjesia e sublimes shfaqet edhe kur përdoret edhe ironia e humori. Për shembull Bardh Dynjaja më parë tregon që është pranuar si arkivist e pastaj nuk e din se kush mund të pranohet, pra është i pasigurt në identitetin e tij sepse kërkon një identitetet të qëndrueshëm, për t’i dhënë kuptim vetes.

“Dhe, këto fjalë që m’u thanë ditën kur i paraqita dokumentet për punësim aty dhe këto fjalë që m’u thanë ditën kur m’u dha dokumenti se jam pranuar në punë aty, më bëjnë të mendoj se unë e di kush jam, por tani për tani nuk mund ta di se kush do të jem!”. (Qosja, 2020: 19)

Në citat, ndjesia sublime që shkaktohet nga tensioni i paradoksit të personazhit, kërkesa e Bardh Dynjajës për ta përcaktuar pozitën e tij si individ apo si përkthyes, nuk është më diçka e shenjtë që i përket dimensioneve hyjnore. Është një fenomen që mund të shihet edhe përmes talljes dhe humorit me kryepersonazhin, edhe kur përdorë tituj e lavdërata të tepërta, edhe kur përmend emra dhe pozita të shumta, shenjtore të mallkuar, protesta dhe hallakamë para teatrit etj. Ndjesia e sublimes në tekst, bëhet një lojë me ndjenjat dhe konceptet e ndërlikuara, ku kontradikta dhe përsëritja janë pjesë e jetës për të cilën shkruhet. Postmodernizmi qosjan, e vë në dyshim natyrën e ndjesisë sublime, duke e transformuar atë në diçka që është e fragmentuar, e ndarë dhe që nuk mund të përjetohet në një mënyrë të pastër dhe të paqëllimshme. Vendosen citate nga romanet e tij dhe nga romanet e traditës, interaksione intertekstuale (reminiscenca) – (Ndjeva një siklet, plot gëlim mendor që ma kishte sjellë në mendje atë shkrimtarin e mendimtarin e Italisë, Umberton, Umberto Ekon... Dhe, i sigurt, prej këtij sikleti, më doli gjumi), dokumente historike e vepra filozofike, lojëra me zhanret – roman omnibus, lojëra postmoderne midis autorit narrator, personazhit e lexuesit – (Unë jam rrëfimtari, e rrëfimtari duhet të jetë më i padukshëm në roman, edhe se personazhi, që lexuesit tua sjell ofshamët). Pra, në romanin postmodern të Qosjes, ndjesia e sublimes shfaqet përmes ironisë dhe kontrastit, tensionit të fragmenteve të narrativës dhe mungesës së kuptimit të plotë. Romani omnibus shënon jo vetëm ndikimin e estetikës postmoderne mbi letërsinë, por edhe mënyrën se si estetika postmoderne ndryshon përvojën e lexuesit përmes një teksti postmodern, në fragmente, paradoksal dhe dekonstruktiv.

Antiheroi

Studiuesja Floresha Dado, ka të drejtë kur definon faktin “që shkrimi i Qosjes, është shkrim postmodern (edhe me elemente ekzistencialiste)”, është një ironi me vetë letërsinë që po na çon në atë pikë, sa duhet të pranojmë faktin që e bukura po zbehet dhe e shëmtuara po fuqizohet deri në atë shkallë sa të themi Lavdëratë kaosit, Lavdëratë disharmonisë. Parabolat postmoderne të Qosjes dallojnë nga parabolat moderne: nëse në parabolat moderne kemi ishullin dhe detin prej ku mund të shohim detin, në parabolat postmoderne, ishulli është i copëzuar në pafundësi pjesëzash të imta, prej ku nuk mund të shihet deti. Thjesht, jemi të humbur në labirintin pa dalje, jemi të humbur në kotësi, e kërkojmë kuptimin, të plotën, por nuk e gjejmë dot. Parabola postmoderne e Qosjes është ironi që mund të qeshni me botën që po shkon drejt kotësisë. “Historinë e bëjnë Gebelsët, Zhdanovët ... Mjerë Historia ... Dhe zbres, në baltë. Me gjithë Historinë”, shënon Qosja në një roman tjetër. Pra, historinë e bëjnë antiheronjtë.

Romani omnibus *Të fshehtat e treguara*, është një roman tipik postmodern, pa një hero në qendër që do ta zhvillonte narracionin. Në qendër të narracionit, është antiheroi i cili përfaqëson të gjithë antiheronjtë e kohës tonë. Janë personazhe këto postmoderne që kërkojnë kuptimin e

thellë të jetës e të botës, në një realitet të pasigurt dhe kaotik. Personazhi Bardh Dynjaja, “ky arkivist e përkthyes me nam”, ka një revoltë të thellë për botën, është paradoksal, është antihero që e shijon lirinë vetëm kur është i pranguar, është antihero që për të qenë i lirë, kërkon edhe të çmendet. Në gjykimin tim, antiheroi i Qosjes, është larg ndjesisë të së bukurës dhe të madhërishmes. Pra, në roman kërkohet subjekti që shijon të bukurën e të madhërishmen, po që mungon, ai nuk mund të shfaqet, sepse nuk është aty. Kërkimi i një personazhi të tillë, është kërkim i asaj që mungon dhe që nuk ekziston më. Në fakt, kërkimi i sublimes, sot është një mision gati i pamundur, sepse është kërkim që të shfaqet ajo që nuk mund të shfaqet. Në romanet postmoderne të Qosjes, mungon subjekti i tillë me shije, sepse subjekti i tillë me ndjesinë e të bukurës dhe të madhërishmes mungon nga bota jonë. Mungon sepse në botë, gjithçka po shkon drejt kotësisë, drejt entropisë dhe drejt zhdukjes. Pra, sublimja ekziston vetëm në teori, edhe atë pse e thotë teoria. Kategoria estetike e sublimes, nuk ndodhet në vepër, për shembull, ju nuk keni personazhe sublime, keni antiheroin, e keni shëmtine, paradoksin e kohës, pra sublim është teksti postmodern, teksti - ngjarje, teksti që ndodh, teksti që përmes lojës e ironisë, siç thotë Lyotard në teorinë estetike të sublimes, përpiqet të shfaqë atë që nuk mund të shfaqet.

Përfundimi

Në romanin postmodern të Qosjes, lexuesi ndjen dekonstruktimin e teorisë klasike të sublimes. Shënohet ndjesia e sublimes si një koncept që lidhet me eksperiencën e thellë dhe shpesh kontradiktore të botës, e tejkalon kuptimin e zakonshëm dhe të njohur. Kjo ndjesi sublime është një përjetim konfuz, i paqartë dhe i pashpjegueshëm sepse efektivizon e thekson tensionin, paradoksin dhe fragmentimin si elemente thelbësore të përvojës.

Romani postmodern i Qosjes, është një palimpsest, dhe koha në të cilën jetojmë është e destinuar për të cituar referenca nga letërsia dhe kultura e të kaluarës, një kohë e reciklimit të vlerave dhe nocioneve të vjetruara. Pikërisht për këtë arsye, sublimja që ndodh këtu dhe tani manifestohet si postmoderna sublime. Ajo shfaqet si pjesë e një estetike të dallimeve dhe si një paradigmë që përpiqet të kap atë që nuk mund të kapet, të shfaq atë që nuk mund të shfaqet, dhe të sublimojë atë që nuk është sublime. Rexhep Qosja përmes romanit të tij, përmes postmodernes sublime, i tejkalon kufijtë e perceptimit të zakonshëm estetik dhe shënon vetëdijen e dallimit midis ndjenjave dhe mendimit, një dallim që pamundëson gjetjen e një kuptimi të plotë, stabil dhe të qëndrueshëm. Mbase kërkon një rifillim të ri.

Referencat

- [1]. Dado, Floresha. (2020) Postmodernizmi – Poetikë e antirregullit, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë.
- [2]. Johnson, David. The Sublime: From Antiquity to the Present, ed. Timothy Costelloe New York: Cambridge University Press, 2012, 118-131.
- [3]. Lyotard Jean Francois. (1983) The postmodern Condition, University of Wisconsin Press, Oxford, Manchester
- [4]. Qosja, Rexhep. (2020) Të fshehtat e treguara, Toena, Tiranë.
- [5] Rexhepi, Afrim. (2010) Dekonstruksioni i estetikës, Selektor, Shkup.
- [6]. Todorov, Tzvetan. (1986) Introduction to Poetics, University of Minnesota Press, Minneapolis
- [7]. www. Dado, Floresha, Rexhep Qosja: Postmodernizëm në letërsinë shqiptare, gaz online Fjala shqip,